

PROTOKOLL

Mbledhja e dytë e kryesisë së shoqatës e thirrur nga kryetari **Ismet Abdyl**

Data: **25.03.2018**

Ora: **12:40**

Vendi: **Glattbrugg**

Pjesmarrës: Ismet Abdyl, Avni Kastrati, Fadil Kqiku, Imran Asllani, Musa Halili

Mungon: Muhamet Guda, Qenan Haziri

Temat e ditës:

1. Kërkesë për vendosjen e shotave përgjatë lumit të fshatit

Kërkesa është parashtruar nga ana e ish anëtarit të kryesis Agron Zahiri.

Kryesia e sheh si një ide jashtzakonisht të mirë dhe janë të gjithë për realizimin e këtij projektit. Mënyra e implementimit të këtij projekti është prezantuar nga Avni Kastrati me një vizatim (Ofertë) të realizuar nga ana e Bujar Hazirit.

Ofertuesi ka ofruar një projekt në të cilin parashihen vendosje e një shtëpize prej drurit, kjo ofertë parashihet që materiale si dhe puna do të realizohen të gjitha nga ana e Ofertuesist (Bujar Hazirit).

Për këtë temë kryesia mendon se duhet të kemi edhe oferta të tjera nga Ofertues të ndryshëm, gjithashtu mendon se skeleti i objektit duhet të jetë me hekur.

2. Shqyrtim për tavolinë të PingPongit

Kryesia mendon të realizoj vendosjen e një apo dy tavolinave të pingpongit me qëllimin që rinia e fshatit të ketë një aktivitet shtesë për kohën e lire. Për realizimin e këtij projektit kryesia kërkon gjetjen e lokacionit më të mirë të mundshëm. Kryesia do të hapë një debatë në faqën tonë në Facebook si dhe organizonë një sondazhë në faqen e shoqatës 17shkurti.ch për lokacionet e mundshme. Pas shqyrtimit të sondazhit si dhe mendimit të të gjithë bashkëshortarëve në Facebook në mbledhjen e ardhshme do të vendosë për realizimin e këtij projekti.

3. Vendosja e ndriqimit të ri

Pas kërkesës së disa bashkëshortarëve për rregullimin e disa dritave në disa vende kyçe në fshat, pasi ndriqimi i tanishëm nuk është shumë funksional, kryesia merr vendim për mbulimin e këtyre hapsirave me ndriqim (LED). Pas evidentimit të hapsirave, shoqata do ta realizoj këtë projekt. Me këtë projekt do të mirret Avni Kastarti.